



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-078

Prishtinë, më 6 dhjetor 2016, në orën 09:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 6 DHJETOR 2016**

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Aida Dërguti dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Fehmi Hyseni, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga NDI-ja: Rinor Beka.

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari procedoi me këtë rend dite:

### **1. Procedimi i Projektligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore të Kosovës, hartuar nga Grupi prej 25 deputetëve nënshkrues**

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

#### **Përfundim**

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Projektligjin për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore të Kosovës, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një muaji nga dita e pranimit.

### **2. Peticioni i qytetarëve lidhur me zbardhjen e rastit të Astrit Deharit**

Kryetari i njoftoi të pranishmit se një numër prej 23 774 qytetarëve të Republikës së Kosovës kanë parashtruar peticion në Kuvend lidhur me zbardhjen e rastit të Astrit Deharit. Peticioni i është dërguar edhe Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Kryesia, pasi diskutoi për peticionin e lartshënuar, konstatoi se që kjo çështje të procedohet për debat duhet pritur rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

### **3. Kërkesa e disa deputetëve të Kuvendit për ndërtimin e Qendrës për takimet “Lutjet e Mëngjesit”**

Kryesia, pasi diskutoi për kërkesën e riproceduar të disa deputetëve të Kuvendit për ndërtimin e Qendrës për takimet “Lutjet e Mëngjesit”, konstatoi se lidhur me kërkesën e lartshënuar duhet t’i analizojë lokacionet edhe një herë, pastaj kërkesa t’u riprocedohet institucioneve kompetente për ndërtimin e Qendrës për takimet “Lutjet e Mëngjesit”.

### **4. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, z. Fikrim Damka, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Turqi**

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## **Vendim**

1. Nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Fikrim Damka, i lejohet udhëtimi zyrtar në Turqi, prej 11-14 dhjetor 2016.
2. Shpenzimet e akomodimit për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet shtesë mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### **5. Kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme për lejimin e udhëtimit zyrtar në Francë**

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

## **Vendim**

1. Anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Elmi Reçica, Teuta Rugova, Qerim Bajrami dhe Puhie Demaku, u lejohet udhëtimi zyrtar në Strasburg (Francë) prej 12 -14 dhjetor 2016.
2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit (tejkalimet eventuale për akomodim), përkthimit, taksitë dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### **6. Kërkesa e kryetarit të Komisionit për Punë të Jashtme, z. Elmi Reçica, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel**

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, e konfirmoi këtë:

## **Vendim**

1. Kryetarit të Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Elmi Reçica, i lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel (Belgjikë), prej 6-9 dhjetor 2016.
2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit (tejkalimet e mundshme për akomodim), të pjesëmarrjes, të përkthimit, shpenzimet eventuale për taksitë dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### **7. Kërkesa e deputetit Zenun Pajaziti për lejimin e udhëtimit zyrtar në Francë**

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, e konfirmoi këtë:

## **Vendim**

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Zenun Pajaziti, i lejohet udhëtimi zyrtar në Francë, prej 6-10 dhjetor 2016.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

## **8. Kërkesa e Shoqatës së Malazezëve të Kosovës për mbështetje financiare**

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

### **Vendim**

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës së Malazezëve të Kosovës për mbështetje financiare në shumën prej 1 500 (njëmijë e pesëqind) euro për mbulimin e shpenzimeve me rastin e shënimit të Jubileut për vitin 2016.

2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere. Mjetet e lejuara të derdhen në llogarinë bankare: Raiffeisen Bank, nr. 1501110000384677.

## **9. Njoftimi i dy nënkryetarëve të Kuvendit lidhur me pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në punimet e Grupit Special të Mesdheut (GSM) dhe Lindjes së Mesme të Nënkomisionit për Partneritet të Asamblesë së Përgjithshme të NATO-s në Romë (Itali)**

Kryesia u njoftua me shkrim me raportin e dy nënkryetarëve të Kuvendit: z. Xhavit Haliti dhe z. Slobodan Petroviq, lidhur me pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në punimet e Grupit Special të Mesdheut (GSM) dhe Lindjes së Mesme të Nënkomisionit për Partneritet të Asamblesë së Përgjithshme të NATO-s në Romë (Itali), nga 26-30 tetor 2016.

## **10. Njoftimi i Komisionit për Integritet Evropian lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Turqi**

Kryesia u njoftua me shkrim me raportin e Komisionit për Integritet Evropian lidhur me vizitat zyrtare të realizuar në Turqi, nga 8-11 nëntor 2016.

## **11. Propozim-Rregullorja për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike: subvencioneve dhe tranfere**

Kryetari i njoftoi nënkryetarët e Kuvendit lidhur me propozim-Rregulloren për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere.

Pastaj, lidhur me këtë propozim-Rregullore e hapi debatin.

Për propozim-Rregulloren e lartshënuar, diskutuan: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Aida Dërguti dhe Xhavit Haliti, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozim-Rregulloren e lartshënuar, me propozimi e nënkryetares së Kuvendit, znj. Aida Dërguti, në nenin 4, paragrafi 1.4, mori këtë:

### **Vendim**

Miratohet Rregullorja nr. 05/Rr-002 për shpenzimin e buxhetit të Kuvendit nga kategoria: subvencione dhe transfere.

#### **Të ndryshme:**

#### **1. Kërkesa e kryetarit të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, z. Xhavit Haliti, për kompensimin e anëtarëve të këtij komisioni**

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

### **Vendim**

1. Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE - Kosovë kompensohen, si në vijim:

- Kryetari i komisionit kompensohet në shumë prej 400 euro në muaj,
- Zëvendëskryetari i komisionit kompensohet në shumë prej 300 euro në muaj,
- Anëtari i komisionit kompensohet në shumë prej 150 euro në muaj, dhe
- Anëtari-zëvendësues i komisionit kompensohet në shumë prej 50 euro në muaj.

2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kryesia e Kuvendit.

#### **2. Autorizimi për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit**

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me autorizimin e lartshënuar, mori këtë:

### **Vendim**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli **autorizohet** që, në rast të pamundësisë për mbajtjen e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të vendosë për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit për deputetët dhe komisionet parlamentare, kur shpenzimet duhet të mbulohen nga Buxheti i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 10:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Kadri VESELI**

*Procesverbalin e hartoi: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*